

Dr. Limon Rushiti

VËSHTRIMI I SHKURTËR I SITUATËS POLITIKE NË KOSOVË (1912—1915)

Lidhur me Paktin Ballkanik, për luftë kundër Turqisë, Dimitrije Tucoviq thotë: „Në aksion të përbashkët kundër Turqisë shtetet ballkanike kanë hyrë duke e ndier veten të paafta që secila për vete në të nuk mund t'i dalë në krye. Ndërsa, në rastin e formimit të bllokut-Aleancës ballkanike, për luftë kundër Perandorisë Osmane me pretekst të çlirimit të popujve ballkanikë Dimitrije Tucoviq, në artikullin „Smetnje na Ballkanu” („Pengesat në Ballkan”) ndër të tjera, shkruante: „Nuk mund të bëhet fjalë për çlirimin e popujve të Ballkanit, ngase çlirimet nuk vijnë nga Pallatet dhe kabinetet, të cilat janë në aleancë apo instrumente të eksploatuesve, masha të thjeshta të diplomacive të fuqive të mëdha kapitaliste. Ato duhet të rrjedhin nga poshtë, prej masave të popullit”.¹ Ky qëndrim nuk ishte vetëm i Tucoviqit, por edhe i tërë PSDS, ngase në Lidhjen Ballkanike e shihnin interesin e borgjezisë, kapitalin europian dhe të diplomacisë ruse. PSDS, në vend të luftës, e cila do të shkretëronte kultura dhe arritjet ekonomike të brezave, e cila do të ngjallë ndjenjat e reja nacionale dhe regjilione të vjetrat do të potencohen, të cilat nëpërmes të vorreve sjellin robëri popujve të cilët do t'u rrënojnë shumë të arritura të punës sonë organizative në shumë vende, në vend të zjarrit luftarak, më së miri do të shkatërrojnë ate çka ka mbjellur reacioni, ne jemi idhtarë të revolucionit i cili sajton kushte më të mira dhe kushtëzon demokraci”.²

Partia Socialdemokratike Serbe nuk ishte as për status quo në territoret turke të Ballkanit. Ajo deklarohet për një revolucion demokratik, nëpërmjet të cilit do të bashkoheshin popujt ballkanikë. „Secila ndarje e Turqisë do të thoshte burim i ri konfliktesh, e lufta është e rrezikshme edhe për Ballkanin edhe për Evropën në tërësi”.³

PSDS nuk ishte në gjendje as të ndalte luftën as të prishte aleancën ballkanike, por me qëndrimin e saj të drejtë, me shkriemet e saj për zgjidhjen e konflikteve, ndihmoi që të kuptohej dhe

¹ „Radničke Novine”, nr. 212, 10. IX. 1912.

² „Radničke Novine”, 20. VII. 1912.

³ *Istorijski Arhiv KPJ*, Tom. III, 257—260.

të zgjidhej sa më drejtë çështja kombëtare. Me të depërtuar thellë në Kosovë, ushtria serbe dëshironte t'i plotësonte orekset e veta imperialiste, që me marrjen e Prizrenit të kalonte në territoret e tashme të RSP të Shqipërisë dhe të dilte në Adriatik. Dëshirë kjo e kahershme e Serbisë. Kështu, i kënaqur me sukseset ushtarake, Nikolla Pashiq në një telegram që i dërgoi Komandës Supreme, më 2 nëntor 1912, thoshte „Sot bisedoj me mua mbreti dhe u interesua shumë që sa më parë të merret Prizreni, unë dhe lartëmadhëria e tij, mëkëmbësi, u pajtuam. Në diplomaci është disponimi i mirë, vetëm këshillojnë që sa më parë të dalin në detin Adriatik, sepse së shpejti do të fillojë aksioni i përgjithshëm i fuqive evropiane për ndërprerjen e luftës dhe fillimin e bisedimeve”.⁴

Para se të fillonte Lufta e Parë Ballkanike, shtetet që kufizoheshin me territoret që mbante Turqia i filluan bisedimet për ndarjen e territoreve, të cilat do t'i fitonin me luftë. Bisedimet ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi filluan edhe para vitit 1911, por në këtë vit ato u shtruan në formë zyrtare. Nikolla Pashiqi në vitin 1911, kur Mali i Zi shtroi haptas çështjen e ndarjes së interesave me Serbinë në territorin e Kosovës dhe të Shqipërisë, për t'i mbuluar në momentin e parë orekset e pangopshme, si diplomat i rryer, reagoi: „Derisa ai popull të mos jetë i lirë, nuk kanë vend pretendimet e askujt, arritjen e këtij qëllimi nuk bën ta pengojë interesi personal i askujt”.⁵

Kjo ishte një manavër politike e Nikolla Pashiqit. Mirëpo, në të vërtetë ai mendonte krejt ndryshe. Ai më tutje thoshte: „Këtë çështje duhet lënë së ardhmes”. Kështu kjo u manifestua në Luftën e Parë Ballkanike, kur rrafshin e Kosovës, Drenicën dhe një pjesë të mirë të Dukagjinit deri në Gjakovë i futi nën sundimin e vet ushtria serbe, kurse pjesën tjetër të Dukagjinit ushtria malazeze. Kufijtë definitivë ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi në Kosovë u caktuan në nëntor të vitit 1913.

Lufta e Parë Ballkanike paraqiti kthesë në historinë e popujve të Ballkanit. Me të u likuidua pushteti Osman, kurse disa shtete fituan territore të reja. Në këtë kohë u krijue shteti shqiptar. Kur është fjala për shqiptarët në Kosovë dhe për popullin maqedon, ata nga kjo luftë nuk fituan asgjë, vetëm e ndërruan pushtetmbajtësin. Shtypja kombëtare, ekonomike dhe politike vetëm sa erdhi e u keqësue.

Ushtria e Mbretërisë serbe vendosi organet e para administrative në institucionet ekzistuese, por me stabilizimin e pushtetit qeveria borgjeze serbe bëri organizimin e ri të organeve administrative dhe riorganizimin territorial. Me riorganizimin e organeve administrative — territoriale dëshirohej të thyhej kompaktësia e popullit shqiptar në një anë dhe për ta pasur situatën në duar të veta, në anën tjetër. Kosova, pjesa nën Serbinë, u ndan në 4 qar-

⁴ AVII, P-2, K-47 dhe *Srbija i Crna Gora u Balkanskim ratovima 1912—1913*, Bgd. 195, 42.

⁵ Dr. Dimo Vujoviq, *Ujedinjenje Crne Gore i Srbije*, Titograd, 1962, 45.

qe: të Prizrenit, Prishtinës, Novi-Pazarit dhe të Shkupit. Me akte të veçanta në nëntor të vitit 1913 u formua Qarku i Zveçanit, i cili përfshinte tri rrethe. Territori i këtij Qarku deri atëherë ishte nën Qarkun e Novi-Pazarit.

Për ta forcuar edhe më pushtetin ushtarak — policor në Kosovë duke aplikuar një politik antishqiptare, asimiluese, qeverisë borgjeze të Nikolla Pashiqit nuk i mjaftonin vetëm kolonizimi dhe masat shumë të rrepta kundër shqiptarëve, në mënyrë që ata të shpërnguleshin, por mori edhe masa të ndryshme administrative duke i justifikuar me dekrete ligje të ndryshme. Kjo bëhej për ta thyer kompaktësin dhe qendresen e armatosur të shqiptarëve. Dr. Dragosllav Jankoviç me të drejtë konstaton se kjo ishte „një nga çështjet më të vështira” me të cilat atakoheshin „qëndrimet e ndryshme të partive politike dhe të grupeve shoqërore”.⁶ Nga ky dhe nga shkaqe të tjera, në nëntor të vitit 1912 u proklamua „Dekretligji për sigurin publike në krahinat e çliruara”, me të cilin parashihehin dhënie shumë të rënda kundër atyre që prishnin rendin publik dhe që i bënin rezistencë pushtetit etj.

Qeveria, në krye të së cilës ishte Partia Radikale me Nikolla Pashiqin në krye, ndaj Kosovës dhe Maqedonisë kishte qëndrim reaksionar borgjez. Të gjitha ato vende, që para depërtimit të osmanlive në Ballkan ishin nën pushtetin mesjetar serb, sipas saj, patjetër edhe tash duhej t'i takonin.⁷ Borgjczia serbe, duke u mbështetur në mendimet e Pashiqit, i cili konsideronte se „sistemi politik-juridik i mbretërisë serbe nuk mund dhe nuk duhej të shtrihet menjëherë (aplikohet L. R.) në krahinat e bashkuara, as popullsia e këtyre vendeve nuk mund dhe nuk bën të ishte e barabartë, me të drejta, me popullsinë e Serbisë. Me atë popullsi, në ato krahina, për një kohë, duhet të sundohet me dekrete ligje të veçanta”.⁸ Në mbështetje të këtij mendimi dhe të dekrete ligjeve të miratuara, u qeveris jo vetëm deri në Luftën e Parë Botërore, por edhe pas saj.

Për shkak të gjendjes të padurueshme nga sundimi shumë i egër, popullsia shqiptare e Kosovës filloi rezistencën gjithnjë e më të madhe. Në pranverë të vitit 1913 pati shumë raste kur i tërë fshatj u arratisë në male për t'iu kundërvënë pushtetit. Kur është fjala për pjesën e Kosovës të bashkangjitur Malit të Zi, me Paqen e Londrës, 1913, (Gjakovën, Pejën, Istogun me territoret e tyre), sundimi ishte edhe më i egër kurse qëndrimi i popullsisë shqiptare ishte pothuaj po ai si nën Serbi. Sa i përket ndarjes territoriale dhe rregullimit administrativ ndryshonte shumë nga ai nën Serbi, për shkak se qeveria e Malit të Zi asnjëherë deri më 1915 nuk mundi ta stabilizonte gjendjen politike.⁹

⁶ *Srbija i Jugoslovensko pitanje 1914—1915*, Beograd, 1973, 78.

⁷ M. Sekuliq, *Kosovo od 1912 do 1918*, (tezë doktorati e mbrojtur më 1980).

⁸ Dr. Dragosllav Jankoviç, *Srbija i Jugoslovensko pitanje 1914—1915*, Bgd. 1973, 79.

⁹ M. Sekuliq, v. c. 245—250.

Pas luftërave ballkanike, e deri më 1915 në territorin e Kosovës mbetën shumë toka të djerrna, pak tokë e lënë feudale shtetërore, pasta j prona private, poseduesit e të cilave duke iu frikësuar pushtetit të ri, ikën në Turqi dhe në Shqipëri. Për qëllime të caktuara, qeveria serbe nxori me 20. II. 1914 Dekretin për konolizimin e „territoreve të çliruara dhe të bashkuara Mbretërisë Serbe”.¹⁰ Çështja e kolonizimit të Kosovës parashihej me nenin 5 të dekretligjit në fjalë.

Në pjesën e Kosovës që e mori Mali i Zi gjendja politike ishte edhe më e keqe. Mbi popullsinë shqiptare ushtrohej dhuna dhe represalje të papara. Qëndrimi i organeve shtetërore të Serbisë dhe të Malit të Zi shkaktuan çrregullime të mëdha në sferën ekonomiko-shoqërore, politike dhe kombëtare në tërë territorin e Kosovës. Si thotë dr. Dragosllav Jankoviç në librin e përmendur, „Kosova konsiderohej territor i okupuar në të cilin u vendos qeverisja ushtarako-policore”.¹¹ Veç veprimeve të para shumë brutale, ata mohuan popujt e tjerë si shqiptarët, turqit etj., që përbënin shumicën. Mirëpo, as popullsia vendase serbe në Kosovë nuk ishte e barabartë në pikëpamje ligjore me serbët në Serbi. Shqiptarët dhe popujt e tjerë, veç serbët, nuk vinin në konsiderim për ndonjë pozitë në jetën shoqërore politike. Mbi ta bëheshin lloj-lloj presionesh për t'i detyruar të shpërnguleshin dhe të asimiloheshin.

Sjelljet armiqësore të borgjezisë serbe dhe malazeze ndaj popullsisë shqiptare bënë që Lëvizja Kombëtare Shqiptare e para luftërave ballkanike në krye me prijësit e mirënjohur si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Buletini etj., të vazhdonte luftën kundër sundesve të rinj. Kështu, më 29 shtator të vitit 1913, shpërtheu një kryengritje e përgjithshme prej Dibre deri në Kërçovë, që u zgjerua edhe në Kosovë. Kjo kryengritje mori një front të gjerë prej Qafës së Thanës deri në Dukagjin. Krezistenca ishte e pranishme në çdo vend dhe bëhej gjithnjë e më e madhe. Komanda e ushtrisë serbe bashkë me qeverinë ishin të interesuara që prijësit e përmendur dhe të tjerë t'i përfitonin ose t'i likuidonin. Komandanti i Armatës së Tretë Serbe, Bozha Jankoviç, konsideronte se kundër udhëheqësve të kryengritësve duhej të veprimeve pamëshirshëm. Ata duhej të vareshin posa të ziheshin, në këtë mënyrë që të frikësoheshin edhe masat e gjera. Në shkurt dhe mars të vitit 1913, afër kufirit shqiptar, mbi Prizren, u tuba një numër i madh shqiptarësh të udhëhequr nga Isa Buletini, të cilëve u ishin ndarë mbi 300 pushkë dhe afro 20 sandakë me municion pushkësh. Në këtë kohë, nga Durrësi arritën në Vlorë 30 prijës të mëparshëm të shqiptarëve nga Kosova.¹²

Për shkak se këto ngjarje po merrnin hov gjithnjë e më të madh në territorin e përmendur të kryengritjes, qeveria e Beogradit u frikësua se do të merrnin përmasa edhe më të mëdha

¹⁰ Dr. Nikola Vučo, *Poljoprivreda Jugoslavije 1918—1941*, Bgd. 1958.

¹¹ Dr. Dragoslav Jankoviç, v. c. 78—83; Dr. Petar Stojanov, *Makedonija vo vremeto na Balkanskite i prvata svetska vojna 1912—1918*, Skopje, 1969.

¹² AVII, Bgd. P-2, K-53, f. 2, dok. 2/27 dhe K-14, f. 1/a.

edhe në brendësi të Kosovës. Duke pasur parasysh këtë ajo e dërgoi Bogdan Radenkoviçin dhe Vojisllav Kovaçeviçin për të vënë kontakt me Parësinë Shqiptare, të cilët i njihnin që më parë, me qëllim që, sipas mundësisë, ta përfitonin që ajo të punonte për çështjen e Serbisë ose, të paktën, të përfitohej kohë për t'u përgatitur kundër veprimtarisë së kryengritësve. Sipas raporteve të kohës, nga Paria Shqiptare e Kosovës me autoritativët dhe më aktivët ishin: Isa Buletini, Elez Jusufi, Bajram Curri, Riza Bej Gjakova, Mersi dhe Shaqir Dema etj.

Qindra kosovarë në mars të vitit 1914 kaluan ilegalisht nga territori i Shqipërisë në territorin e Qarkut të Prizrenit, më së tepërmi në rrethin e Rahovecit dhe të Gorës, për të ngritur popullsinë në kryengritje. Në rrethin e Rahovecit qendra kryesore ishte në fshatin Banjë. Kuvendi më i madh dhe i fundit para kryengritjes u bë në një livadh të rrethuar nga të gjitha anët me male, në mes të Banjës dhe fshatit Carallukë. Sipas një shkrese të Ministrisë së ushtrisë, kjo kryengritje shpërtheu rreth 26—30. III. 1914 në fshatin Banjë, nga i cili vend mori përnasa të gjera. Në krye të kësaj kryengritjeje, sipas dokumentit në fjalë, ishte Sadri Abazi nga Këravasaria.¹³

Kufiri ndërmjet Malit të Zi dhe Serbisë më 1912 filloi të vije me hyrjen e fuqive ushtarake serbe dhe malazeze në Kosovë, sipas marrëveshjes së mëparshme. Komanda Supreme e Ushtrisë Serbe i urdhëroi më 30. X. 1913 komandantit të Ushtrisë së Ibrit që me forcat kryesore të nisej nga Mitrovica në drejtim të Pejës. Më parë kolonisë së 11 të thirrjes së dytë i urdhërohej që në të njëjtën ditë të zinte pozicione nga fshati Klina e Epërme deri në fshatin Kovragë, dy kilometra në perëndim të Brusnikut.¹⁴

Me tërheqjen e ushtrisë turke Prizreni disa ditë qëndroi pa kurrfarë pushteti. Më 30 tetor 1912, me insistimin e Jefta Gapiqit, Fetar Kostiqit e të shtyer edhe nga konsulli rus i cili edhe vetë shkoi në Suharekë për t'i dhënë kurajë komandantit të ushtrisë serbe të një njësie të vogël të kalorësisë prej 97 ushtarësh, për të hyrë në Prizren. Njëسيا e përmendur e ushtrisë serbe me të hyrë në Prizren bëri manovrime të shpeshta në qytet dhe rreth tij për të lënë përshtypje se janë një numër i madh ushtarësh me këso lloje të manevrimeve ajo vazhdoi deri më 4 dhe 5 nëndor, kur arrijnë divizioni i Shumadisë i cili menjëherë ndryshoi situatën më të mirë të ushtrisë serbe.¹⁵

Hyrja e Ushtrisë Mbretërore Malazeze në Pejë më 30. X. 1912 u bë në orën 10, kurse në orën 14 arriti komanda e Aradhës së Lindjes me serdar Janko Vukotiqin në krye. Ushtria malazeze në Pejë u vendos në këtë mënyrë; Brigada e Eeranës (Ivangradit) në skaje të qytetit, në pjesën veriore të tij. Brigada e Durmitorit me Shtabin e Aradhës në Patriarsni, e Kollashinit në rajonin e fshatit Bellopojë. Për sigurimin e prapavijës u dërguan në drejtim të Is-

¹³ DASIP. MID. f. 3. 14. IV. 1914.

¹⁴ *Prvi Balkanski rat*, lib. 1. 855.

¹⁵ Dr. Borislav Ratkoviç, *Prvi Balkanski rat 1912—1913*, lib. 2. Beograd, 1975, 248.

togut të Rudnikut njësi të vogla vëzhguese por edhe për të vendosur lidhje me njësitë e ushtrisë serbe, të cilat po depërtonin nga ai drejtim.¹⁶

Me vendosjen e ushtrisë malazeze nëpër vendet e përmendura, komandanti i këtyre trupave, serdar Janko Vukotiqi, iu drejtua popullit të Pejës dhe të rrethinës me një proklamata me të cilën e ftonte të jetë e qetë dhe t'u përmbahej ligjeve malazeze. Menjëherë u organizue pushteti policor, Shef u emërua Marko Kusovaci, kurse sekretar Milorad Protiqi. Po ashtu u formua edhe xhandarmëria. Komandant i saj, me urdhrin e komandantit të Aradhës së Lindjes, u emërua Sava Llazareviq-Batarja, kurse oficer Mihajlo Anxhelliqi, Simo Medenica, Millan Rakoçeviqi, Boshko Bullatoviqi, Vojin Ceroviqi, dhe Lllazar Gogoviqi. Në shërbim të xhandarmërisë u caktuan 200 veta. Prej tyre 100 ishin ushtarë nga Brigada e Durmitorit dhe 100 të tjerë serbë e malazezë vendas nga Peja, në të cilët organet shtetërore kishin besim të plotë dhe ishin lojalë ndaj pushtetit.

Organet ushtarake dhe shtetërore malazeze, duke u frikësuar nga turbullirat, kryengritja e përgjithshme popullore, nxituan që edhe formalisht të formonin organet shtetërore. Kështu, menjëherë formuan organin e përkohshëm krahinor dhe gjyqin përkatës. Njerëzit e zgjedhur në këto organe u vërtetuan nga organet më të larta të qeverisë malazeze me 3 nëntor të vitit 1912.

Personelin qeveritar të organit krahinor e përbënin; kryetar - Jovan Plamenaci, sekretar Nikolla Jovanoviqi dhe Millan Çukoviqi, notarë Milivoje Joksimoviqi, Jovan Bojoviqi dhe Risto Rashoviqi, komandir Beqo Vllahoviqi, kapiten Milia Karaxhiqi, Kërsto Topaloviqi, Milia Vujsiqi dhe Nikolla Bullatoviqi. Sekretarë të Gjykatës Krahinore (prefekturë) u emëruan: Tomica Çukiqi, Milosav Kastratoviqi dhe Marko Cvjetkoviqi, kurse notarë Zharko Anxhellkoviqi, Milunja Lekiqi dhe Simo Shukoviqi. Me të njejtën urdhëresë u bë edhe konstituimi i Gjykatës Komunale. Kryetar u caktua Jovan Geriqi, kurse anëtarë: Aziz beg Shaban Begolli, Jovan Anxhellkoviqi, Salih agë Nushi, Zhivko Bojeviqi, Mahmut beg Sokolloviqi dhe Axhi Babë — (sic). Sekretarë u caktuan Nikolla Golluboviqi, Millan Kovaçeviqi dhe Kosta Vasileviqi, kurse notar Zarija Ratkoviqi.¹⁷ Sipas disa të dhënave zyrtare, këto organe shtetërore filluan të funksiononin në mënyrë efikase edhe pse menjëherë hasen në rezistencën e popullsisë shqiptare. Po më se matej efikasiteti i organeve të pushtetit malazez? Së pari me qëndrimin tejet brutal, kur emri i komandantit të xhandarmërisë, Sava Llazareviqit, u bë personifikim i tmerrit. Ai i pushkatonte njerëzit pa zbritur nga kali. Për krimet që bëri mbi popullin shqiptar atë e quanin Savë „batarja”. Po nuk mund të thuhet se këtu pushteti ishte efikas në zgjidhjen e çfarëdo problemi, përveç helmimit të marrëdhënieve ndërnacionale të këtyre popujve që me shekuj ki-

¹⁶ Pavle Millosheviq, *Operacije Istočnog odreda Crnogorske vojske u Sandjaku, gornjem polimlju i Metohiji 1912 god.* „Istorijski zapisi” sv. 3—4, 1972, 366.

¹⁷ Pavle Milošević, *Po aty.*

shin jetuar në bashkëjetesë dhe fqinjësi të mirë. Ndërkaq, organet shtetërore, për shkak të pamundësis së vendosjes së një pushteti stabil, në Pejë qëndruan një kohë shumë më të gjatë, sesa e kishin planifikuar qeveritarët.

Ushtria malazeze në territorin e Dukagjinit kudo depërtoi me armë. Brigada e Veshoviqit erdhi në Pejë pasi nënshtroi Plavën dhe Gucinë, nga të cilat doii më 27 tetor. Më 28. X. 1912 hasi në rezistencë të fortë të shqiptarëve në terren të maleve Bogiqeviq-Gjeravic. Më 1 dhe 2. 11. 1912 kjo Brigadë u gjend në territorin e Deçanit, nga depërtoi në 3 kolona në drejtim të Junikut, me qëllim që sa më parë të depëronte në Gjakovë. Gjatë këtij depërtimi, më 2 nëntor, hasi në rezistencë të vendi i quajtur Krshi Merggegës. Forcat shqiptare i udhëhiqte Bajram Curri. Pas një lufte të rreptë, shqiptarët detyrohen të tërhiqen për shkak të epërsisë numerike dhe të paisjes me armë të ushtrisë malazeze. Ushtria malazeze depëronte me të shpejt me qëllim që sa më parë ta marrte Gjakovën dhe të depëronte në Prizren, i cili, sipas marveshjes serbo-malazeze, do ti takonte atij i cili depërton i pari. Në Deçan ushtria malazeze dëgjon se Prizrenin e kishte marrë ushtria serbe, e cila pastaj depëronte në drejtim të Gjakovës. Për këtë shkak Brigadiri Veshoviq kërkoi leje nga Janko Vukotiqi që t'i lejonte depërtimin sa më të shpejtë në drejtim të Gjakovës, të cilën e filloi më 3. XI në drejtim të fshatrave Loxhë, Voksh dhe Junik. Kështu, më 4. XI rreth orës 11 u nis nga Juniku për në Gjakovë. Nga shpatiet e Çabratit ushtria malazeze u prit me zjar nga forcat shqiptare të udhëhequra nga Bajram Curri. Në të njëjtën kohë, nga lindja Gjakovën e sulmuan forcat e ushtrisë serbe, të divizionit të Drinës. Kështu, forcat shqiptare që mbronin qytetin nuk mund t'u bënin ballë forcave shumë më të mëdha të ushtrisë serbe dhe malazeze dhe për këtë shkak rreth orës 17 filluan të tërhiqen në grupe në drejtim të Malësisë.¹⁸

Si shihet, në Gjakovë përnjëherë hynë dy ushtri, të dy shteteve. Me këtë rast u shkatua konflikti se cilës palë duhej t'i takonte qyteti, se cila palë do të kishte përfitime më të mëdha. Ky konflikt u ndërpre me ndërmjetësimin e oficerëve të lartë, çështja u zgjidh përkohësisht në atë mënyrë që ushtria serbe ngeli në pjesën e qytetit, në anën e djathtë të lumit Krena, kurse në anën e majtë të këtij lumi ngeli ushtria malazeze. Ndarja e tillë e qytetit dhe ndalimi i ngatërresave ndërmjet këtyre dy ushtrive u bë pas marrëveshjes që arritën serdari i ushtrisë malazeze, Janko Vukotiqi dhe gjenerali i ushtrisë serbe, Mihajlo Zhivkoviç në Pejë. Ushtria serbe hyri në Pejë mbas ushtrisë malazeze dhe me lejen e saj. Ato u morën vesh aty për ndarjen e Gjakovës. Pas kësaj u nisën nga Peja për në Gjakovë, ku dhe i mënjanuan ngatërrimet ndërmjet ushtrive dhe caktuan vijën e demokracionit. Kjo ndarje e qytetit të të Gjakovës mbeti deri në nëntor 1913, kur u bë caktimi i kufijve ndërmjet Malit të Zi dhe Serbisë dhe Gjakova mbeti nën Malin e Zi.

¹⁸ Po aty.

Ushtria malazeze formoi pas disa ditësh organet qeveritare në Gjakovë. Në pjesën e vet ajo formoi të ashtuquajturën qeveri krahinore, pastaj policinë dhe xhandarmërinë. Në krye të pushtetit në fjalë u caktua Jevren Bakiq, kurse policinë e udhëhiqte Perisha Lekiqi. Ky organ më tepër vepronte në qytet, kurse xhandarmëria, e udhëhequr prej Sava Memedoviqit, e përbërë prej 150 ushtarëve të zgjedhur, kishte kompetenca të mëdha, si në rrethinë, si në qytet, për të mbajtur rendin dhe qetësinë. Organet malazeze në Gjakovë formuan dhe shërbimin e intendanturës, i cili bënte furnizimin e organeve shtetërore, të policisë e të xhandarmërisë në qytet dhe në rrethinë.¹⁹

Gjakova ishte vendi i fundit në Kosovë që e muarën dy ushtritë e përmendura, të cilat gadi një vit e mbajtën të ndarë ndërmjet tyre. Kral Nikolla i Malit të Zi, menjëherë pas hyrjes në Gjakovë, urdhëroi që pjesa më e madhe e Aradhës së Lindjes në nisej menjëherë për në rajonin e Shkodrës, të cilën Mali i Zi ëndërronte ta bënte kryeqendër të veten. Në urdhëresën në fjalë, kral Nikolla ua tërhoqi vërejtjen organeve ushtarake që para se të caktonin trupat për në drejtim të Shkodrës, të bëhej sigurimi i pushtetit malazez në Gjakovë dhe rrethinë, për shkak se nga 71.839 banorë, të kombësisë serbe ishin 687.²⁰ Numri i ushtrisë në këtë terren ishte më i madh në krahasim me vendet që i kishte në duar të veta ushtria malazeze.

Me hyrjen e forcave ushtarake të Serbisë e të Malit të Zi në Kosovë filloi mobilizimi i njerëzve të kombësive të ndryshme për në çeta çetnike serbe. Ushtria serbe, sipas urdhëresës së Komandës Supreme Serbe rez. nr. 6132 të muajit maj të vitit 1913,²¹ realizoi idenë për formimin e njësive vullnetare në territorin e Maqedonisë dhe të Kosovës. Qëllimi i formimit të këtyre njësive ishte „për shkak të luftës eventuale në terrenin e okupuar, prandaj është e nevojshme të bëhet regjistrimi i vullnetarëve serbë, turq dhe shqiptarëve nga Maqedonia dhe Kosova”²² pastaj i „kolonisë vullnetare” me forcë ushtarake prej 4 batalionesh, të cilat do të dislokoheshin në këtë mënyrë; 1. Në Sveti Nikolla (Maqedoni), 2. në Prishtinë 3. në Gjevgjeli dhe 4. në Negotinë të Vardarit (Maqedoni).

Në këtë, ta quajmë rend ushtarak, kërkohet të inkuadroheshin shqiptarët, turqit e të tjerë. Për t'u regrutuar në këto njësi kërkohet plotësimi edhe i disa kushteve të veçanta si personi të jetë i shëndoshë psikikisht dhe fizikisht për përdorimin e armës, të ketë shërbyer në ushtri etj. Në këtë rend ushtarak pranoheshin dhe ish-oficerët që kishin shërbyer në ushtrinë turke, madje, me kusht që t'i mbanin gradat që i kishin patur në ushtrinë turke. Të gjithë ata që hynin në radhët e kësaj ushtrie gëzonin disa beneficione, ndër të cilat ishin: rrobat, sipas mundësisë kapela ushtarake serbe — (shajkaqen nuk ishin të obliguar ta banin nëse nuk

¹⁹ *Po aty*, 376—377.

²⁰ Pavle Milošević, p.c. 337.

²¹ AVII, p-2, K-1.

²² *Po aty*, urdhëresa e Komandës Supreme Ushtarake nr. 6132, maj 1913.

dëshironin). Kishin të siguar një bukë në ditë dhe 0,50 para për çdo ditë. Kishin po ashtu të ardhura mujore, të cilat caktoheshin sipas gradës ushtarake; për ushtarë 20 dinarë në muaj, për oficerët e ulët 20—30 dinarë, e për oficerët e lartë 50 dinarë. Obligim i detyrueshëm i të gjithë të rekrutuarve ishte që të bënin betimin për besnikërinë ndaj komandantit suprem të ushtrisë serbe, mbretit Petrit I Karagjorgjeviq. Pas kësaj të gjithë ishin nën mbrojtjen e ligjeve ushtarake të ushtrisë serbe dhe i nënshtroheshin përgjegjësisë, sipas tyre.²³ Në Kosovë sundohej sipas ligjeve ushtarake dhe i gjithë pushteti ishte në duart e ushtrisë (edhe pse figuronin institucionet shtetërore administrative). Kështu sa u përket çetave çetnike, ato ishin nën sundimin e organeve të qarkut. Këto çeta, kur dilnin në aksion në të shumtën e rasteve përbëheshin prej 10 vetave-çetnikëve. Organet e qarkut ishin të obliguara t'u siguronin një kal ose gomar, për bartjen e ushqimit, të municionit, të rrobave e të tjera. Çetnikët me këto gjëra kishin leje të furnizoheshin nga popullsia me anë të rekuizimit. Njësitë vullnetare-batalionet, derisa nuk përdroreshin për veprime ushtarake, ishin nën komandën e Komandës Supreme të Ushtrisë Serbe, të formuar posaçërisht për këtë, që ishte një administratë e veçantë. Me formimin e plotë të tyre dhe kur caktohej detyra konkrete operative, vetëm atëherë i bashkoheshin ndonjë njësie.²⁴

Formimi i këtyre njësive elite kishte për qëllim të zhvillonte luftë guerile kundër forcave të rregullta të armatosura ose kundër grupeve të lëvizjes së rezistencës kundër ushtrisë dhe pushtetit serb. Këto njësi vepronin si në territorin e Serbisë se Luftës Ballkanike, si në territoret që i mori pas. Prandaj, nëse në këto njësi, si në Serbi, ashtu edhe në Kosovë e në Maqedoni, u inkuadrue vullnetarisht popullsia serbe, kjo nuk vlente për popullsinë shqiptare. Shqiptarët u mobilizuan kryesisht me dhunë në këto njësi. Ata u futën në Batalionin II, i cili përkohësisht e kishte selinë në Prishtinë. Në këtë batalion parasnihej të inkuadroheshin njerëzit e mobilizuar nga Qarku i Prizrenit, Prishtinës, Novi-Pazarit dhe i Plevlës.²⁵

Batalionet „vullnetare”, të cilat qeveria serbe dëshironte t'i formonte dhe ato të ishin të mëdha e të fuqishme e të përbëheshin prej të gjitha kombësive që e banonin Kosovën, kishin jo vetëm rëndësi, por edhe qëllim të shumëfishtë. Së pari, qeveria serbe ishte e vetëdijshme se lufta me Bullgarin ishte e pashmangshme, për shkak të mos përbajtjes së kontratës mbi ndarjen e territoreve në Maqedoni. Së dyti, frika nga kryengritja e përgjithshme kundër saj, e kjo ishte e pranishme në Kosovë, sa u përket shqiptarëve, sepse një numër i meshkujve të aftë për luftë ndodheshin në male me pushkë në dorë, të cilët luftonin kundër pushtetit mizor ushtarak, i cili që në vjeshtë të vitit 1912 kishte marrë masa shumë të rënda kundër popullsisë shqiptare.

Komanda Supreme e Ushtrisë Serbe, për të pasur sukses në këtë punë, porosiste eprorët ushtarak që vepronin në formimin e këtyre batalioneve, që me anën e agjitimit sa më të mençur, t'i

²³ *Po aty.*

²⁴ Petar Stojanov, v. c. 93, 94.

²⁵ AVII, P-2, K-1, Komanda Supreme rez. nr. 6131 më 18. III. 1913.

përfitonin pjesëtarët e kombeve të ndryshme ta pranonin sa më lehtë mobilizimin. Kështu, te popullsia serbe propagandohej se ata (serbët) „janë të obliguar të na ndihmojnë si çlirues të tyre”. Kurse popullit shqiptar i thuhej „Shtabi, duke formuar këto batalione vullnetare dhe duke i pranuar ata (shqiptarët) si të tillë, vullnetarë në radhët e këtyre batalioneve, pa i prekur në ndjenjat fetare dhe të tjera zakone të tyre, madje duke u siguruar edhe nga një prijës religjioz — (hoxhë L.R.), për çdo batalion, nuk bëjnë kurrfarë dallimi ndërmjet tyre, se ata janë të barabartë me të gjitha gjërat, e edhe në ushtri, të cilën duhet ta kryejnë me nder”.²⁶

Kur është fjala për shqiptarët, me këtë propagandë dëshirohej të arrihej që së paku të regjistrohej nga një prej secilës shtëpi. Me këtë propagandë merreshin jo vetëm organet ushtarake, por të gjitha organet shtetërore, si naçallnikët e qarqeve, rretheve, kryetarët e komunave, njerëz të paguar për këtë qëllim. Madje organet shtetërore i mobilizonin shqiptarët me dhunë në këto batalione. Mirëpo, sa i përket mobilizimit të shqiptarëve doli ashtu si parashihte Komanda Supreme. Në këto batalione „vullnetare” nga regjioni i Rrafshit të Kosovës nuk u regjistrua asnjë shqiptar. Shkaqet ishin të njohura: së pari shqiptarët nuk luftuan kundër Turqisë për të zavendësuar sundimin me një tjetër. Së dyti, shqiptarët nuk e njihnin këtë regjim dhe ishin kundër tij.

Ushtria serbe „regjistrimit” — rekrutimit të shqiptarëve në këto batalione i dha rëndësi të madhe jo vetëm për ta shtuar numrin e ushtrisë së vetë, por për ndonjë luftë eventuale me Bullgarinë. Këtë e bëri nga frika se shqiptarët një luftë të tillë do ta shfrytëzonin për llogari të tyre prandaj qëllimi ishte që numri i tyre të jetë sa më i vogël në shtëpi, e, në anën tjetër, që të mobilizuarit t’i shërbenin si pengje. Prandaj së pari ajo mobilizoi me dhunë popullsinë e qyteteve, ku e kishin më lehtë dhe në mënyrë që t’i mbanin nën kontrollë, e kështu t’i zinte ngushtë edhe familjet e tyre. Organet më të larta ushtarake porositnin organet lokale, të cilat bënë rekrutimin, që mobilizimi të bëhej me dhunë dhe të mos lihej në dëshirën e tyre, që nesër të vihej në dyshim suksemi.²⁷

Mobilizimi i popullsisë nuk dha rezultate të kënaqshme. Në fund të majit 1913, organet shtetërore sollën në Ferizaj 1400 të mobilizuar nga Mitrovica dhe Gjilani, kurse nga Ferizaj me rrethinë mezi u mobilizuan 107²⁸ serbë e shqiptarë. Të mobilizuarit nga Kosova dhe Sanxhaku dërgoheshin më së tepërmi në Maqedoni dhe inkuadroheshin në njësitë ushtarake serbe. Shkak i dërgimit të tyre në Maqedoni ishte se pritej një luftë e sigurt me bullgarinë. Kjo dhe ndodhi, shpërtheu Lufta e Dytë Ballkanike. Kështu, sipas një raporti të Armatës së Tretë të 6 qershorit 1913. dërguar komandës Supreme të Armatës Serbe, mësojmë se në fillim të qershorit nga Kosova ishin dërguar në Veles 230 të mobilizuar

²⁶ AS, MPB, p. f. 22, 1/1913, Reparti operativ pranë Komandës Supreme rez. nr. 6132, 16. V. 1913.

²⁷ *Po aty*, rez. nr. 6132, 16. V. 1913.

²⁸ AVII, P-2, K-15, dok. 14/6, 7, 8, f. 1.

65 i takonin besimit muhamedan, kurse 165 besimit të krishterë. Derisa në Shkup u tubuan 800 njerëz, shumica ishin nga Kosova,²⁹ si thuhet ne raportin e përmendur. Të gjithë „vullnetarët” organet ushtarake i dërguan në Ferizaj, të cilët, pas një kohe, protestuan shumë rreptë kundër mobilizimit duke thënë se nuk janë vullnetarë por janë sjellë këtu me dhunë. Në këtë mënyrë protestuan edhe myslimanët nga Sanxhaku dhe shqiptarët në Prishtinë, Shkup, Veles etj. Protestat e tyre sa vinin e shtoheshin sa më tepër që ofrohej Lufta e Dytë Ballkanike. Të mobilizuarit me dhunë në Ferizaj njoftuan nëpërmjet përfaqësuesve të vet përfaqësuesin e Komandës Supreme të Ushtrisë Serbe se i kishin mobilizuar me dhunë, se nuk ishte fjala për shprehjen e kurrfarë vullneti të tyre që inkuadroheshin në ushtri, prandaj kërkonin që të liroheshin prej këtij obligimi të dhunshëm.

Më 11. VI. 1913, Komanda Supreme njoftohet nga Prishtina me telegram se „vullnetarët” në Ferizaj refuzonin të pranonin ushqimin, „që i ngjan demonstratës”. Organet ushtarake të hetuesisë dëshironin të dinin se cilat ishin shkaqet. Shqiptarët deklarorin para organeve të hetuesisë se buka të cilën ua jepnin ishte e përzier me yndyrë derri dhe i frikoheshin helmimit.³⁰ Mirëpo, shkaku i vërtetë i protestës së tyre-mospranimi i bukës, kishte karakter tjetër. Ai doli në shesh në prag të Luftës së Dytë Ballkanike. Shqiptarët deklarorin se mezi prisnin që organet ushtarake t’i armatosnin, e posa të fillonte lufta do të ishin në anën e të fortit.³¹ Nga këto deklarime u frikuan jo vetëm ushtarët, në mesin e të cilëve ndodheshin shqiptarët e mobilizuar, se me shpërthimin e luftës ata armët do t’i përdornin kundër tyre e jo kundër bullgarëve. Komandanti i Armatës së Tretë (III) gjenerali Bozho Jankoviq, deklaroi se njësi:ë e tilla janë të papërdorime për ushtri prandaj duhet të rasformohen, nga shkaku se jo vetëm që nuk janë të dobishme, por mund të jenë shumë të damshme në kohë të luftës.³² Si duket, Komanda Supreme e Ushtrisë Serbe, duke pasur parasysh, edhe këto ngjarje së shpejti i rasformoi këto njësi.

Kufijtë ndërmjet Serbisë e Malit të Zi në territorin e Kosovës

Pretendimet, si të Mbretërisë Serbe, si të Malit të Zi, për përfitim të territoreve në Kosovë, ishin të mëdha. Çështja e përfitimve territoriale e këtyre dy shteteve ishte kryesore, prandaj edhe luftimet kufitare që u bënë gjatë gjithë kohës deri në Luftën e Parë Botërore, ishin të kësaj natyre. Kështu, deri në nëntor të vitit 1913 vetë qyteti i Gjakovës ishte i ndarë ndërmjet dy shteteve. Kufijtë definitivë ndërmjet këtyre dy shteteve u caktuan pas Konferencës së Ambasadorëve në Londër.

Kufijtë ndërmjet Malit të Zi dhe Mbretërisë Serbe në nëntor 1913 në territorin e Kosovës përafërsisht ishin këta: duke fi-

²⁹ *Po aty*, dok. nr. 2907, 6. VI. 1913.

³⁰ *Po aty*, Telegram nga Prishtina 29. V. 1913 dhe 11. VI. 1913.

³¹ Dr. Petar Stojanov, *v. c. f.* 95—96.

³² *Po aty*.

lluar nga Sanxhaku një pjesë në rrjedhën e lumit Devoli, i cili derdhet në lumin Ibër, aty ku derdhet prroni Jabllanica. Këtu kufiri këpuste lumin Ibër dhe ngjitej prronit Jabllanica përpjet në malet e Moknës, duke dalur në majen e këtij 1500 m lartësi, me të njëjtin emër. Më tutje kufiri leshohej anës së kësaj bjeshke nëpër vendin Çereftuj duke dalë nga rrjedha e epërme e lumit të Rakoshit nëpër të cilin lumi shkonte kufirit deri në derdhjen e tij në lumin e Klinës. Kufiri më tutje vazhdonte për lumin Dri deri në kufirin shqiptaro-serbo-malazez, të caktuar në Konferencën e ambasadorëve në Londër,³³ por luftërat ndërmjet tyre nuk ndalen deri në fund të dhjetorit të vitit 1913.

Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës më 1912 nën Mbretërinë Serbe

Menjëherë pasi merren në dorë këta vende, organet ushtarake vendosin organet e veta administrative në institucionet ekzistuese. Këto organe ushtarake vendosën pushtetin dhe e mbajtën një kohë të gjatë.

Territori i Kosovës nën Serbi ishte i ndarë në këto qarqe: të Prishtinës, Prizrenit, Novi Pazarit, Kumanovës dhe të Shkupit. Kjo ndarje zgjati deri në nëntor të vitit 1913, kur me akt të posaçëm të MPB u formua Qarku i Zveçanit me qendër në Mitrovicë, në të cilën bënin pjesë këto rrethe: i Mitrovicës, i Vuçitërnës dhe i Drenicës.³⁴

Aktet e para mbi rregullimin administrativ dhe territorial të këtyre vendeve u shpallën më 14—27. XII. 1912 me Dekretligjin mbi sundimin e përkohshëm të vendeve të marra me Luftën e Parë Ballkanike, i cili dekret hyri në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të mbretit Petar I Karagjorgjeviq.³⁵

Me dekretin e përmendur u abroguan të gjitha organet e mëparshme me përjashtim të qendrave administrative, që mbetën po ato, ndonëse i gjithë aparati u ndërrua dhe u vendosën organet të tjera të pushtetit.³⁶ Këto ndërrime duhej të vlenin vetëm në momentin e parë të vendosjes së pushtetit, ngase pas kësaj kohe këto ndërrime do të mund të bëheshin vetëm me lejen e Ministrisë së Punëve të Brendshme, derisa kufijtë komunalë i caktonte pushteti i rrethit. Gjerësia territoriale e komunës varej nga pozita e saj gjeopolitike, madhësia e fshatrave që bënin pjesë në të, nga përbërja e popullsisë dhe nga qëndrimi i saj ndaj organeve të pushtetit. Në këtë kohë copëtimi ishte shumë i madh, territoret e komunave ishin shumë të vogla, më qëllim që prania e organeve të pushtetit të ishte sa më e madhe, për shkak të rezistencës së popullit. Çështja e copëtimit të territoreve komunale ishte më e theksuar në viset kufitare.³⁷

³³ DASIP, MID, Po. 1913, f. 13, dos. 3, dok. 6609, 7052.

³⁴ AS. MPB, P. O. f. 15, r. 143/1913.

³⁵ *Fletorja zyrtare ushtarake*, nr. 1, 17. I. 1913.

³⁶ *Službene novine*, nr. 181, 12. VIII. 1913.

³⁷ *Po aty*.

Pushtetin komunal e përbënin kryetari, nga një kryeplak prej secilit fshat që bënte pjesë në atë komunë, një ose më tepër notarë, sipas nevojës, dhe nga një numër i mjaftueshëm i njerëzve të armatosur. Zgjedhjen e organeve të pushtetit komunal ligji në fjalë e parashihte ta bënin organet e pushtetit të rrethit. Të gjithë funksionarët komunalë emëroheshin nga njerëzit më të aftë të atij territori, por kishte mundësi që të emëroheshin njerëz më të aftë edhe nga territoret tjera me kusht që të bëheshin banorë të përhershëm i asaj komune. Këta njerëz duhej të ishin të sigurt, të besueshëm të pushtetit. Kryetarit të komunës i lihej në kompetencë pranimi dhe lëshimi i shërbëtorëve komunalë dhe i atyre të armatosur, sipas rezultateve të punës së tyre. Lëshimin e njerëzve të armatosur nga detyra mund ta bënin edhe organet e pushtetit të rrethit nëse vërenin se ata nuk ishin duke i kryer si duhet detyrat.³⁸

Sipas këtij dekretligji, pushteti komunal në kompetencat e tij kishte, përveç pushtetit administrativ dhe policor, edhe atë gjyqësor. Me këtë dekret parashihej që kryetari i komunës të ishte njëkohësisht edhe gjyqtar. Në kompetencat e tij ishte të zgjidhte kontestet gjyqësore të qytetarëve për pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme me vlerë prej 20 deri në 50 dinarë. Kryepleqtë e fshatrave ishin të autorizuar t'i gjykonin gjërat me vlerë deri me 20 dinarë. Në çdo komunë, qoftë fshatare, qoftë në qytet, ekzistonte dhe gjykata komunale, në kompetencën e të cilës ishin ato lëndë gjyqësore, vlera materiale e të cilave kalonte shumën e përmendur më parë e të denonte më tepër se 10 ditë burg. E drejta e tij ishte edhe për delikte dhe dënime më të rënda. Këto gjykata vepnin më tepër në zgjidhjen e kontesteve të tokës — pronësisë, të fuqizimit të mëtejshëm të marrëdhënieve feudale, shitëblerjen, zgjidhjen dhe vendosjen në ankesa kundër kryepleqve nga ana e qytetarëve.³⁹

Të ardhurat personale për komuna i caktonin organet e pushtetit të rrethit, por edhe për këtë më parë ishte i nevojshëm mendimi i Këshillit të komunës. Për lartësinë e të ardhurave organet komunale dhe ato të rrethit ishin të obliguara të merrnin pëlqimin e organeve më të larta. Financimi i komunës nuk bëhej vetëm nga buxheti që caktohej nga organet më të larta, por burim të financimit kishte edhe të ardhurat nga pasuria komunale dhe nga tatiimi i veçantë komunal.⁴⁰ Buxhetin për komuna fshatare e caktonte prefekti i qarkut, kurse për komuna të qytetit, në të cilat ndodhej selia e qarkut, e caktonte Ministria e Punëve të Brendshme.⁴¹ Nga këto burime financiare, sipas dekretligjit në fjalë, financohej edhe ushtria që ndodhej nëpër komuna.⁴²

Këshilli komunal, sipas këtij dekretligji, përbëhej nga përfaqësuesit e banorëve të asaj komune, që zgjedhej në mbledhjet komunale. Këshillin komunal e zgjedhte pushteti i rrethit. Numri i

³⁸ Po aty, neni 8.

³⁹ Po aty, neni 5, 7, 8, 9.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Po aty.

⁴² Po aty.

këshilltarëve komunalë varej nga numri i banorëve. Kështu, komuna që kishte mbi 100 shtëpi, këshillin komunal të sajë e përbënin 10 këshilltarë, ndërsa ajo që kishte deri në 200 shtëpi, këshilli përbëhej prej 15 sish, ndërsa mbi 200 e përbënin 20. Sipas këtyre normave ligjore, në këshillin komunal përpjesëtimisht me numrin e shtëpive ishin të përfshira edhe në këshillin komunal. Shërbimi i tyre ishte pa pagesë për një vit, çdo vit zgjedheshin këshilltarë të rinj.

Me këtë dekretligj caktohej funksioni dhe roli i rretheve si njësi administrative — territoriale dhe politike. Çdo komunë duhej t'i takonte një rrethi. Në krye të rrethit ndodhej nënprefekti i rrethit, i cili në emër të rrethit kryente pushtetin administrativ dhe policor, të cilin e emëronte Drejtorati Suprem me propozimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Detyra të tjera të nënprefektit të rrethit ishin udhëheqja me pasurinë shtetërore, zgjidhja e konflikteve ndërmjet qytetarëve për pasurinë e paluajtshme dhe çështje të tjera publike, gjyqësore dhe policore.⁴³

Territori më i madh se rrethi ishte Qarku, i cili, poashtu, përfaqësonte qeverinë shtetërore. Në krye të këtij pushteti qëndronte prefekti i qarkut. Të gjitha njësitë administrative më të vogla se ky ishin nën sundimin e tij. Ky organ shtetëror, sipas nevojës, mund të bënte ndërrimin e njerëzve në poste të ndryshme politike, administrative, policore dhe gjyqësore në qark. Kishte të drejtë, por edhe obligim ligjor, të vendoste për të gjitha ato gjëra që ishin vendosur nga organet e rretheve ose nga komuna. Vendimi i këtij organi ishte meritör.⁴⁴

Në kohë lufte prefekti i qarkut ishte i obliguar të bënte rekrutimin e të gjithë njerëzve të aftë. Në këtë dekretligj të gjithë nëpunësit dhe punëtorët e organeve administrative gjyqësore e policore ishin të obliguar ushtarakë (në kohë lufte) të shërbenin në ushtri, pa marrë parasysh moshën e tyre.⁴⁵

Mosnënshtrimin e popullsisë shqiptare të Kosovës para organeve ushtarake të Serbisë Nikolla Pashiqi e shpjegonte dhe e arsyetonte me faktin se „mentaliteti i tyre ndërroi nga sundimi shumëshekullor turk”, e këta — populli shqiptar nuk i përmbushte detyrimet e veta ndaj shtetit, „ngase qeveria turke i favorizonte, por edhe pse në të mbretëroi gjendja anarshike. Për këtë shkak, ky popull duhet të sundohet me norma — ligje të dorës së fortë të pushtetit në mënyrë që të mësohet t'i nënshtrohet normave shtetërore dhe të përmbushë detyrimet e veta”.⁴⁶ Pashiqi konsideronte se këto vende duhej të sundoheshin me ligje të posaçme, së paku një decenje, duke menduar se brenda kësaj kohe shqiptarët ose do të bëheshin pacifistë ose qeveria do të kishte sukses t'i shpërngulte nga Kosova.

Se politika e Pashiqit dhe qëllimet e tij tashmë ishin të paralizueshme filluan të binden edhe organet e tjera menjëherë pasi

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Shiqo: Dr. Dragoslav Janković, *Srbija i Jugoslovensko pitanje 1914—1915*, Bgd. 1973, 79.

hynë në Kosovë. Rezistenca e popullit ishte e llojllojshme dhe masive. Që në fillim ushtria serbe dhe malazeze hasën në rezistencë të armatosur, të grupeve të organizuara. Popullsia u tërhoq nëpër vendstrehime të ndryshme, si në male e vende të tjera. Me vete mori bagëtinë gjërat ushqimore dhe krejt ç'pati mundësi, duke i ikur kështu ndeshjes me ushtrinë. Këto grupe njerëzish me familje qëndruan nëpër male deri në vjeshtë e vonë dhe deri atëherë kur ushtria i gjurmonte nëpër male dhe i detyronte të ktheheshin. Çështë e vërteta, familje të tëra morën arratinë duke iu frikësuar reprezaljeve të ushtrisë dhe grupeve plaçkitëse. Raste të vrasjeve dhe plaçkitjesh të pasurisë ishin të shumta. Prandaj edhe frika e popullsisë ishte e arsyeshme, kurse rezistenca e armatosur e njerëzve të organizuar kishte thjesht karakter politik. Për këtë arsye rezistenca e grupeve të organizuara nuk duhet të konsiderohet si gjë e rastit apo se këto grupe në fillim kishin qëllime të tjera. Shtimin e këtyre grupeve dhe i njerëzve në to u bë edhe për shkak të ndryshme, por qëllimi i rezistencës ishte i njëjtë. Këtu bëjnë përjashtim vrasësit, hajnat etj.

Lufta e popullit shqiptar kundër regjimit ushtrako-politor sa vinte e merrte përmasa më të gjera. Duke e parë këtë qeveria serbe dhe duke u frikësuar se çështja shqiptare po kalonte kufijtë e Ballkanit dhe po bëhej çështje ndërkombëtare, filloi të ndërrojë disa gjëra në politikën e vet ndaj shqiptarëve.

Vazhdimësia e rezistencës së shqiptarëve në Kosovë më së miri dëshmohet në kryengritjen e vitit 1913. Lufta e Dytë Ballkanike dhe situata e përgjithshme politike ndërkombëtare ndikuan që në Serbi, në vjeshtë të vitit 1913 dhe në fillim të vitit 1914, të bëhen disa korigjime të akteve normative, me të cilat sundohej në Kosovë dhe në Maqedoni. Në fillim të vitit 1914, u bënë disa ndërtime të Dekretligjit mbi sigurinë publike, u morën disa masa filletare gjoja për zgjidhjen e çështjes agrare. Në këtë kohë u formuan disa komisione shtetërore, si: Inspektorati ekonomik për Kosovë dhe Maqedoni dhe komisionet të tjera, që kishin për detyrë të merrnin me studimin e disa çështjeve në terren. Këto u bënë për arsye të ndryshme, që ndër më të rëndësishmet ishin qetësimi i shqiptarëve, ngase situata e përgjithshme ndërkombëtare nuk ishte e mirë dhe që nëpërmjet këtyre komisioneve të zbuloheshin disponimi, gjendja ekonomike, shpirtërore dhe ndjenja kombëtare e shqiptarëve dhe qëndrimi i tyre ndaj Serbisë. Në anën tjetër bëheshin përpjekje që me premtime të përfitohen disa krerë të shqiptarëve, e posaçërisht ata që nga karakteri ishin labilë. Në kushtet e tilla të përgjithshme politike si brenda, ashtu edhe jashtë, e posaçërisht lufta me Austro-Hungarinë për çdo ditë pritej që të shpërthei.

Me këtë dëshirohej që marrëdhëniet e brendshme politike të stabilizoheshin, të zbuteshin situata në Kosovë dhe në Maqedoni në mënyrë që ushtarët e ardhshëm nga këto vende t'i shërbenin me besnikëri.⁴⁷

⁴⁷ Dr. Dragosllav Janković, *Srbija i Jugoslovensko pitanje, 1914—1915*, Bgd. 1973, 83.

Këto shkaqe e detyruan qeverinë serbe të deklarohej dhe të lëshonte një proklamantë në dhjetor të vitit 1914, me anën e së cilës i shpallte të barabartë, se popujt e Kosovës dhe të Maqedonisë do t'i gëzojnë të gjitha të drejtat sikurse ata të territorit të Serbisë të para vitit 1912, se të gjitha ligjet që aplikohen në Serbi do të vlejné edhe në këto territore me të gjitha të drejtat qytetare.⁴⁸ Deklaratat dhe proklamatat mbetën vetëm deklarata dhe proklamata, sepse gjendja nuk u përmirësua, por përkundrazi gjendja e tyre vetëm u keqësua deri në Luftën e Parë Botërore.

Çështja agrare — kolonizimi

Vendosja e familjeve serbe në viset e ndryshme të Kosovës filloi menjëherë pas Luftës së Parë Ballkanike. Në rend të parë u vendosën njerëzit e pushtetit, të cilët u emëruan në poste të ndryshme shtetërore si nëpunës, oficerë e të tjerë. Një pjesë e vogël, e nxitur nga situata e volitshme e krijuar në Kosovë, filluan të blenin pasuri të ndryshme të paluajtshme, si në qytete, ashtu edhe në fshatra, nga familjet shqiptare dhe turke, të cilat shpërnguleshin për në Turqi e gjetiu. Gjithashtu, vendosja e familjeve bëhej edhe në shtëpitë — pasuritë e lëna shkret nga familjet vendëse, të cilat, të frikësuara, ende pa hyrë ushtria kishin lënë pasuritë dhe ishin tërhequr.

Qeveria borgjeze serbe qysh para fillimit të luftërave ballkanike në kuadrin e propagandës së vet kishte menduar edhe për çështjen agrare, por vetëm deri aty ku i konvenonte. Më 5 tetor 1912, me rastin e shpalljes së luftës Turqisë, ajo me një proklamant iu drejtua popujve që ende ndodheshin nën pushtetin turk se: „feudalizmi me anën e forcës, të keqpërdorimeve e të kërcënimeve të ndryshme ende qëndron, është bërë i padurueshëm... se Serbia u siguron të gjithë popujve të njëjtat të drejtat dhe liri, sepse një gjendje e tillë është bërë e padurueshme për serbët, maqedonët, grekët dhe shqiptarët, se të gjithë janë duke protestuar, si muhamedanët, katolikët dhe ortodokset”.⁴⁹ Më tutje në proklamantë thuhej se ushtria në këto vende do të hasë në serbë, myslimanë e në shqiptarë të krishterë e myslimanë me të cilët populli ynë jeton bashkërisht që 1300 vjet, duke ndarë të mirën dhe të keqën. Kjo proklamantë kishte për qëllim qetësimin e shpirtrave, kinse ajo do të zgjidhte çështjen agrare, do të rëronte një sistem feudal të kalbur e do të formonte një tjetër, kurse, në të vërtetë, nuk zgjidhi asnjë çështje me interes për masat e gjera popullore. Madje në shumë sfera veptoi në të kundërtën. Duke përfunduar këtë proklamantë thuhej se „ne të gjithëve ua sjellim lirinë, vllazërimin dhe barabarsinë me të gjitha, me serbët”.⁵⁰

Me këtë, si thotë Dragisha Llapqeviq, Serbia obligohej t'i shpartallonte marrëdhëniet feudale dhe sistemin feudal, në mënyrë që

⁴⁸ Dr. D. Janković, *Jugoslovensko pitanje i Krfska deklaracija 1917*, Bgd. 1967, 104—105.

⁴⁹ Dr. M. Obradović, *Agrarna Reforma i kolonizacija na Kosovu 1918—1941*, Prishtinë, 1981. 23.

⁵⁰ *Po aty*.

fshatarin ta lironte nga varësia robëruese e çifçiun ta bënte posedues të lirë të tokës.⁵¹ Të gjitha këto ishin vetëm fraza, sepse në këtë drejtim qeveria e Serbisë nuk bëri asgjë. Sistemin feudal — të çiflikut nuk e preku për shkak të interesit politik klasor. Kështu, kolonizimi i egër vazhonte, kurse premtimet e veta qeveria jo vetëm nuk i përmbushi, por as që u kujdes për ndonjë normë ligjore deri më 20. II. 1914. Me datën e përmendur Qeveria mbretërore serbe proklamoi Dekretin mbi kolonizimin në „vendet e çliruara dhe të bashkuara Mbretërisë serbe”. Ky dekret u plotësua më 9 maj 1914,⁵² por si dekreti, ashtu edhe plotësimi, nuk parashihnin zhdukjen e marrëdhënieve feudale. Prandaj, as në aspektin klasor as kombëtar nuk bëri ndonjë ndërrim përmirësimi të gjendjes materiale, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare të popullsisë në Kosovë. Kolonizimi u bë i ligjshëm, filluan të plotësohen tokat dhe shtëpitë e zbrazëta të mbeta shkret nga famijet e ikura, të ndahet toka e tyre, nga merretë shtetërore të formohen fshatra të reja, si p.sh. fshati Tankosiq.⁵³

Në pjesën e Kosovës që e mori Mali i Zi e cila ishte edhe më e interesuar për çështjen e kolonizimit në Dukagjin, jo vetëm për shkaqe politike, por edhe ato ekonomike, Qeveria e Kral Nikolla Petroviqit në dhjetor të vitit 1913 formoi zyrtarisht një komision agrar me qëllim të regjistrimit të popullsisë dhe të pasurisë së pajuajtshme, për të evidentuar pasurinë shtetërore e për të bërë kështu të mundur planifikimin e kolonizimit të malazezëve në Dukagjin. Ky komision, pos vështirësive ekzistuese, krijoi edhe vështirësi të tjera, meqë nuk e pranonte gjendjen ashtu si ishte në terren, por kërkonte që tapia ta kishte vjetërsinë 50 vjet, për t'ia pranuar pronësinë poseduesit të tokës. Se në çfarë reagimi dhe indinjate hasi në popull kjo, vetvetiu mund të merret me mend. Komisioni në fjalë ia paraqiti më 20 shkurt 1914 qeverisë raportin se për kolonizim ishte përgatitur një sipërfaqe toke prej 4373 plugje.⁵⁴ Qeveria me këtë nuk qe e kënaqur, sepse kishte paraparë që në Dukagjin të ishin së paku 55000 plugje tokë për kolonizim. Për këtë shkak, në mars të vitit 1914 e rasformoi këtë komision, kurse gjeometrave iu dha urdhër t'i bashkoheshin komisionit të formuar nga gjenerali Radomir Veshoviq, i cili u caktua që më tutje të udhëhiqte me kolonizimin në Dukagjin.

Qeveria e Malit të Zi i shpalli të vetat të gjitha ato toka për të cilat poseduesit e tyre nuk kishin dokument me shkrim për ta dëshmuar pronësinë. Që të mund ta ndalte shitblerjen e tokës dhe atë ta fuste në fondin për kolonizim, më 16. I. 1913 nxori Dekretin, me të cilin shpallej e pavlefshme çdo kontratë marrëveshtje tjetër mbi shitblerjen e tokës. Kështu, 2600 plugje tokë në rrethinën e Gjakovës ishin planifikuar për kolonizimin e 500 familjeve. Qe-

⁵¹ Dragisha Lapçeviq, *O agrarnom problemu, Sarajevo 1919.*

⁵² M. Obradoviq, *v. c. f. 24.*

⁵³ A. Urosheviq: *Agrarna reforma i naseljavanje*, „Spomenica” 25 god. oslobodjenja južnih krajeva, Skopje, 1937.

⁵⁴ M. Obradoviq, *p. c. 27*; Gjoko Pejoviq, *Agrarna politika C.G. Vlade u novonaseljenim krajevima 1912*, „Istorijski Zapisi” 1—2. 1955, 216.

veria e Malit të Zi e legalizoi kolonizimin me ligjin e 27. II. 1914. Ky ligj, si dhe ai i vitit 1913, ndaloi shitblerjen e tokës. Këshilli për kolonizim përbëhej prej 4 anëtarësh, të cilët i propozonte Ministria e Punëve të Brendshme me pëlqimin e këshillit ministror e të cilët i emëronte Krali. Përfaqësuesit e këtyre komisioneve për kolonizim në Kosovë në territorin e Malit të Zi ishin në Pejë dhe në Gjakovë. Familja kolonizuese në Kosovë gëzonte beneficione, toka që i jepej pa pagesë ishte e liruar prej të gjitha tatimeve për 10 vjet, (përveç atij kishtar dhe për shkolla). Ai bëhej posedues i tokës nëse në afatin prej 5 vjetësh vendosej me familje në shtëpinë që ia jipte shteti ose ngritte ndërtes banimi për familje.

Ky ishte një vështrim i shkurtër për situatën politike në Kosovë më 1912—1915, në pretendim që të përfshihem të gjitha problemet dhe dukuritë në Kosovë në periudhën në fjalë, deri në Luftën e Parë Botërore, e cila shqiptarëve të Kosovës u solli vetëm vuajtje e skamje të mëdha. Lufta e Parë Botërore vetëm e ndali marrjen e tokës dhe ndërpreu kolonizimin mirëpo solli vështirësi edhe më të mëdha.

Dr. Limon Rushiti

UN APERÇU SUR LA SITUATION POLITIQUE EN KOSOVÉ DE 1912 A 1915

R é s u m é

Dans ce court aperçu sur la situation politique en Kosovë de 1912 à 1915, nous avons tenté de mettre en relief, en quelques mots les tendances et les intentions des Etats balkaniques. Or, nous y avons mentionnés la Serbie et la Monténégro dont la Kosovë se trouvait sous leur domination. Le but de tous les deux était l'aspiration pour les nouvelles terres et non la liberation du peuple assujeti par les Turcs depuis cinq siècle comme disaient tous les deux. Ils n'appotterent pas de liberté ni au peuple serbe qui était en petit nombre par rapport aux Albanais qu'ils faisaient la majorité.

C'est avec un decert spécial par lequel ils dominaient en Kosovë pendant cette époque — la, onme traite pas égal ie serbe de Kosovë avec le serbe de la Serbie.

Des le début, le peuple albanais fut persécuté par des moyens et des formes les plus rigoureux, commença l'enlèvement des terres des payasans albanais, leur expatriation en Turquie et en Albanie qu'elle venait d'être constituée. Les Albanais s'opposèrent au régime par l'arme en main en ne l'acceptant pas et pendant les anné 1913 et 1914 ils se soulevèrent en insurrection.

Le parti social-democrate serbe sous la conduite de Dimitrije Tucoviq critiqua ce régime bourgeois serbe par ses écrits dans son journal „Radničke Novine”, mais la bourgeoisie serbe ne voulait pas écouter ces protestations et d'autres, elle faisait tout le possible de coloniser la Kosovë changeant ainsi son aspect ethnique.

La Première guerre mondiale interrompit la colonisation et l'expatriation en Turquie, mais la pauvreté et la misère continuèrent toujours sous l'Austro-Hongrie et la Bulgarie, car le pays fut partagé entre eux.